STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 17 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE BORDI DREJTUES I SUNI-t (SUNY) DO TE RIKTHEJE PAGESEN PER SHKOLLE TE STUDENTEVE QE U LARGUAN SI REZULTAT I URAGANIT SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Bordi Drejtues i Universitetit Shtetëror të Nju Jorkut (State University of New York Board of Trustees) unanimisht miratoi një rezolutë duke autorizuar presidentët e kompleksit universitar që të rikthejnë pagesat për shkollë të studentëve të detyruar që të largohen për shkak të pasojave shkatërruese të Uraganit Sendi (Sandy).

"Studentët e SUNY-t (SUNY) studimet e të cilëve u ndërprenë nga Uragani Sendi (Sandy) nuk kanë nevojë të shqetësohen në lidhje me rimarrjen e parave të tyre dhe përkundrazi mund të përqëndrojnë energjinë e tyre tek familjet e tyre dhe rindërtimin," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Komplekset universitare të SUNY-t (SUNY) kanë shërbyer si zona grumbullimi të punëtorëve të ndihmës së emergjencës dhe hapën dyert e tyre si streha për fqinjët e tyre në nevojë. Studentë nga i gjithë shteti kanë organizuar dhurime dhe grumbullime fondesh. Përgëzoj Kancelaren Zimfer (Chancellor Zimpher) dhe Kryetarin Mekoll (Chairman McCall) për partneritetin e vazhdueshëm të tyre në reagimin e shtetit dhe përpjekjet e rimëkëmbjes."

Kryetari i Bordit Drejtues të SUNY-t (SUNY) H. Karl Mekoll (H. Carl McCall) tha, "Jemi krenarë t'u ofrojmë studentëve tanë të prekur nga kjo stuhi shkatërruese një mënyrë për të rimarë çdo kosto që ka lidhje me një arsimim të SUNY-t që nuk janë në gjendje të përfundojnë. Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka treguar udhëheqje të shkëlqyer ndërsa Nju Jorku (New York) vazhdon të rindërtohet pas Uraganit Sendi (Sandy) dhe Universiteti Shtetëror i Nju Jorkut (State University of New York) është i gëzuar të ndjekë shembullin e tij dhe të bëjmë pjesën tonë për të lehtësuar barrën mbi studentët tanë."

Kancelarja e SUNY-t (SUNY) Nensi L. Zimfer (Nancy L. Zimpher) tha, "Ndërsa komplekset tona universitare bashkohen me komunitetet dhe vazhdojnë të kontriubojnë ndaj përpjekjeve të ndihmës në disa zona të Nju Jorkut (New York), është vetëm e përshtatshme që t'u ofrojmë studentëve të SUNY-t atë që mundemi për të siguruar njëfarë ndihmë financiare gjithashtu. Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e vazhdueshme të tij pas stuhisë së tmerrshme dhe falënderoj Bordin Drejtues që lejoi që komplekset tona universitare të rikthejnë pagesën për shkollë për studentët që janë prekur."

SUNY (SUNY) është duke autorizuar presidentin e secilit kompleks universitar që të heqë detyrimin e pagesës për shkollë dhe të rikthejë pagesën për shkollë për studentët që largohen simestrat e vjeshtës 2012 dhe/ose pranverës 2013 për shkak të vështirësive të shkaktuara nga Uragani Sendi (Sandy). Rregulloret e Universitetit Shtetëror parashikojnë për largime të "vështirësive" dhe rikthimin e pagesës për shkollë, sipas gjykimit të secilit president të kompleksit universitar, por vetëm në rast se një student largohet përpara mesit të një simestri akademik. Meqënse Uragani Sendi (Sandy) ndodhi pas mesit të simestrit të vjeshtës 2012 dhe për shkak të shkallës së stuhisë, udhëheqja e SUNY-t (SUNY) ndryshoi rregulloren për të ndihmuar që studentëve t'u shmangen vështirësi të tepëruara.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418